

IEBV SPV shpk
Nr 372 Prot
Dt. 15.10.2018

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet me vullnet të plotë e të lirë, sot me datë 15/10/2018, midis palëve:

- **Shoqërisë koncesionare “INTEGRATED ENERGY BV SPV” SH.P.K**, themeluar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, me NIPT L72031013B dhe adresë: Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Bulevardi Gjergj Fishta, Nr.48, e përfaqësuar nga Administratori **Z. Giuseppe Ciaffaglione**.
- **Policia Bashkiake Tiranë** me seli, Rruga e Kavajës, ish-Uzina Mekanike përfaqësuar nga **Z. Ermal Kapllani**
- **Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, pranë Bashkisë Tiranë**, me seli Sheshi "Skënderbej",Nd. 2, përfaqësuar nga **Z. Taulant Tusha**
- **Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë** me seli, Eduard Mano, Liqeni i Thatë, afër Kopshtit Zoologjik përfaqësuar nga **Z. Evisjon Salku**.

Shoqëria **“Integrated Energy BV SPV”** Shpk është shoqëria koncesionare e cila më datë 31/08/2017, ka lidhur kontratën konçensionare me Nr.prot.6597 **“PËR NDËRTIMIN LANDFILLI, INCENERATORI DHE REHABILITIM I VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANË DHE PRODHIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE” (Zona e Trajtimit të Mbetjeve Tiranë, më tej referuar si ZTMT)**, me Autoritetin Kontraktor Ministria e Mjedisit (kaluar kompetenca pranë Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës);

Policia Bashkiake Tiranë, është instanca kompetente për monitorimin dhe kontrollin e territorit të Bashkisë Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, pranë Bashkisë Tiranë, është instanca e drejtpërdrejtë e procesit në marrëdhënie me koncesionarin Integrated Energy BV SPV Shpk

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë është instanca e cila në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi si dhe bazuar në ligjin Nr 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” është kompetent bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin të kryejë inspektime periodike ose jo periodike pranë subjekteve të inspektimit me qëllim evidentimin e rasteve të shkelësve të legjislacionit mjedisor në fuqi.

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi me kushtet si më poshtë:

NENI 1: QËLLIMI I AKT-MARRËVESHJES

1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është koordinimi midis Policisë Bashkiake në funksion të rolit që ajo ka për monitorimin dhe kontrollin e territorit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë si institucioni me kompetenca të plota për evidentimin, kontrollin dhe marrjen e masave administrative për shkelësit si dhe shoqërisë koncesionare “ Integrated Energy BV SPV” shpk si përgjegjëse në bazë të kontratës koncesionare për menaxhimin e të gjitha kategorive të mbetjeve të cilat depozitohen pranë ZTMT, referuar zbatimit të legjislacionit mjedisor në fuqi me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të qytetarëve dhe marrjen e masave për të gjithë shkelësit e legjislacionit të sipërpërmendur .

NENI 2 DETYRIMET E PALËVE


2.1 Detyrim i palëve është dhënia e informacionit të ndërsjelltë me qëllim realizimin e qëllimit të kësaj akt marrëveshjeje cituar në nenin 1.

2.2 Detyrim i palëve është vendosja e personave të kontaktit të cilët do të jenë dhe personat nëpërmjet të cilëve do të realizohet shkëmbimi i informacionit.

2.3 Detyrimi i palëve për evidentimin dhe ndalimin e të gjithë shkelësve të legjislacionit mjedisor në fuqi në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

NENI 3 AFATI I AKT-MARRËVESHJES

3.1 Palët bien dakort që kjo marrëveshje bashkëpunimi të jetë me një afat të papërcaktuar dhe të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj.



NENI 4
PERSONAT E KONTAKTIT

4.1 Për Policinë Bashkiake Tiranë:

Emër/Mbiemër: **Ermal Kapllani**

Cel: 0692046645

Email: _____

4.2 Për Integrated Energy BV SPV Shpk:

Emër/Mbiemër: **Giuseppe Ciaffaglione**

Cel: 0689089452

Email: info@iebv.al

4.3 Për Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, pranë Bashkisë Tiranë:

Emër/Mbiemër: **Taulant Tusha**

Cel: _____

Email: _____

4.4 Për Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë:

Emër/Mbiemër: **Evisjon Salku**

Cel: 0684735426

Email: _____

NENI 5
DISPOZITA TË FUNDIT

5.1 Legjislacioni i zbatueshëm për marrëveshjen është ai shqiptar dhe veçanërisht Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe legjislacioni mjedisor në fuqi.

5.2 Çdo ndryshim i kushteve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të bëhet me shkrim, nëpërmjet një amendamenti të nënshkruar nga palët, përndryshe konsiderohet i pavlefshëm.

5.3 Marrëveshja e bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 kopje me vlerë të barabartë juridike, si dhe pasi u lexua e kuptua, nënshkruhet nga palët.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

Për Policinë Bashkiake Tirane:

Ermal Kapllani



Për Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë

Evisjon Salciu




Për Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, pranë Bashkisë Tiranë

Taulant Tusha



Për Integrated Energy BV SPV Shpk

Giuseppe Ciaffaglione



MINUTA TAKIMI

Lënda: Mbi një bashkëpunim ndër-institucional referuar zbatimit të legjislacionit mjedisor në fuqi me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të qytetarëve.


Të pranishëm:

- Koncesionari, Shoqëria “**Integrated Energy BV SPV**” Shpk perfaqësuar nga Z. **Giuseppe Ciaffaglione**
- Policia Bashkiake Tiranë përfaqësuar nga Z. **Toni Beni**
- Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë përfaqësuar nga Z. **Evisjon Salku**

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi problematikat e hasura në zbatimin e parashikimeve ligjore në fushën e mjedisit brënda territorit të Bashkisë Tiranë, shkeljet e herëpashershme të cilat cojnë në ndotjen e mjedisit dhe rrjedhimisht ndikojnë në cilësinë e jetës së të gjithë qytetarëve brënda këtij territor, si dhe mundësinë e vendosjes së një mënyre komunikimi dhe bashkëpunimi midis Policisë Bashkiake në funksion të rolit që ajo ka për monitorimin dhe kontrollin e territorit Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë si institucioni me kompetenca të plota për evidentimin, kontrollin dhe marrjen e masave administrative për shkelësit si dhe shoqërisë koncesionare “**Integrated Energy BV SPV**” shpk si përgjegjëse në bazë të kontratës koncesionare për menaxhimin e të gjitha kategorive të mbetjeve të cilat depozitohen pranë ZTMT.

Gjatë këtij takimi perfaqësuesit e instancave të përmendura më sipër propozuan dhe vendosën sa më poshtw:

1. Vendosjen e një bashkëpunimi ndër-institucional ku secili prej pjesëmarrësve të përfshirë do të luaj një rol të rëndësishëm në ushtrimin e kompetencave të dhëna nga ligji apo kontrata koncesionare.
2. Bashkëpunimi do të ketë të bëjë me vendosjen e një ure komunikimi e cila do të konsistojë në dhënie të informacionit të ndërsjellë midis palëve me qëllim bashkërendimin e punës dhe zgjidhjen e problematikave të diskutuara.



3. Lidhjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis palëve , e cila do të firmoset nga personat përgjegjës e cila do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.
4. Përcaktimin e personave të kontaktit për mbarëvajtjen e kësaj marrëveshjeje, nëpërmjet të cilëve do të bëhet dërgimi i informacionit.

Data: 17.09.2018

Për Policinë Bashkiake Tirane:

Toni Beni

Për Inspektoratin Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë

Evisjon Salku

Për Integrated Energy BV SPV Shpk

Giuseppe Ciaffaglione

